ABSTRAKT

TEMA: Njohuritë dhe nevojat për zhvillim profesional të stafit infermieror të Shërbimit të Onkohematologjisë Pediatrike në QSUNT lidhur me kujdesin paliativ.

MSc. Gloria Bengaj[1], BSc. Enerida Lamcellari[1], MSc. File Bracja[2], Prof. Asoc. Donjeta Bali (Alia)[3], Dr. Mirzana Kapllanaj[4]

[1] Infermiere pranë Shërbimit të Onkohematologjisë Pediatrike, QSUNT
[2] Infermier, Koordinator, Shoqata Brainstorm
[3] Shefe e Shërbimit të Onkohematologjisë Pediatrike, QSUNT
[4] Mjeke pranë Shërbimit të Onkohematologjisë Pediatrike, QSUNT

Hyrje: Kujdesi paliativ pediatrik synon përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve me sëmundje kërcënuese për jetën dhe mbështetjen e familjeve të tyre. Në onkohematologjinë pediatrike, infermierët përballen me sfida emocionale dhe profesionale, ndërsa njohuritë dhe përgatitja e tyre për këtë kujdes shpesh mbeten të pamjaftueshme.
Qëllimi: Të vlerësohet niveli i njohurive të infermierëve të onkohematologjisë pediatrike për kujdesin paliativ dhe të identifikohen nevojat e tyre për trajnim.
Metodologjia: U krye një studim përshkrues, sasior dhe ndërseksional, ku morën pjesë 16 infermierë të stafit të Shërbimit të Onkohematologjisë Pediatrike në QSUNT, gjatë periudhës 1–8 tetor 2026. Të dhënat u mblodhën në mënyrë anonime përmes një pyetësori të administruar në Google Forms, i cili përfshinte të dhëna demografike dhe profesionale, vlerësimin e njohurive mbi kujdesin paliativ përmes instrumentit *Palliative Care Quiz for Nursing* (PCQN), si dhe vlerësimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional.
Rezultatet: Në studim morën pjesë 16 infermierë, të gjithë femra. Grupmosha më e përfaqësuar ishte 21–30 vjeç (37.5%). Gjysma e pjesëmarrësve (50%) kishin diplomë Master i Shkencave, 37.5% Bachelor në Infermieri dhe 12.5% Master Profesional. Gjysma e pjesëmarrësve (50%) kishin marrë më parë trajnim në kujdesin paliativ, kryesisht përmes organizatave ose projekteve (50%) dhe universiteteve/institucioneve arsimore (37.5%). Në vlerësimin përmes PCQN, pjesëmarrësit arritën një rezultat mesatar prej 6.94 pikësh nga 20 të mundshme (34.7%), duke evidentuar boshllëqe në njohuritë mbi kujdesin paliativ. Shumica (81.3%) raportuan nevojë për trajnim të mëtejshëm. Nevoja më e lartë u evidentua në kujdesin në fund të jetës (3.88/5), e ndjekur nga pikëllimi dhe zia (3.63/5) dhe komunikimi me fëmijën dhe familjen (3.56/5). Forma më e preferuar ishte trajnimi i kombinuar teorik dhe praktik (75%).
Përfundime: Studimi evidentoi mangësi në njohuritë e stafit infermieror dhe nevojë për trajnim të mëtejshëm në kujdesin paliativ, veçanërisht në kujdesin në fund të jetës, pikëllimin dhe zinë, si dhe komunikimin me fëmijën dhe familjen. Rekomandohen trajnime të strukturuara teorike dhe praktike për forcimin e aftësive profesionale.
Fjalë kyçe: kujdesi paliativ, onkohematologji pediatrike, infermierë, njohuri, nevoja për trajnim.

ABSTRACT

TOPIC: Knowledge and Professional Development Needs of Nursing Staff in the Pediatric Oncohematology Service at QSUNT Regarding Palliative Care

MSc. Gloria Bengaj[1], BSc. Enerida Lamcellari[1], MSc. File Bracja[2], Assoc. Prof. Donjeta Bali (Alia)[3], Dr. Mirzana Kapllanaj[4]

[1] Nurses at the Pediatric Oncohematology Service, QSUNT
[2] Nurse and Coordinator, Brainstorm Association
[3] Head of the Pediatric Oncohematology Service, QSUNT
[4] Physician at the Pediatric Oncohematology Service, QSUNT

Introduction: Pediatric palliative care aims to improve the quality of life of children with life-threatening illnesses and provide support to their families. In pediatric oncohematology, nurses face emotional and professional challenges, while their knowledge and preparation for providing this type of care often remain insufficient.
Aim: To assess the level of knowledge of pediatric oncohematology nurses regarding palliative care and identify their training needs.
Methodology: A descriptive, quantitative, cross-sectional study was conducted involving 16 nurses from the Pediatric Oncohematology Service at QSUNT during the period October 1–8, 2026. Data were collected anonymously through a questionnaire administered via Google Forms. The questionnaire included demographic and professional information, an assessment of palliative care knowledge using the Palliative Care Quiz for Nursing (PCQN), and an assessment of training and professional development needs.
Results: A total of 16 nurses participated in the study, all of whom were female. The most represented age group was 21–30 years (37.5%). Half of the participants (50%) held a Master of Science degree, 37.5% held a Bachelor's degree in Nursing, and 12.5% held a Professional Master's degree. Half of the participants (50%) had previously received training in palliative care, mainly through organizations or projects (50%) and universities/educational institutions (37.5%). In the PCQN assessment, participants achieved a mean score of 6.94 out of 20 possible points (34.7%), indicating gaps in their knowledge of palliative care. The majority (81.3%) reported a need for further training. The highest training need was identified in end-of-life care (3.88/5), followed by grief and bereavement (3.63/5) and communication with the child and family (3.56/5). The most preferred training format was a combination of theoretical and practical training (75%).
Conclusion: The study identified gaps in nursing staff's knowledge and a need for further training in palliative care, particularly in end-of-life care, grief and bereavement, and communication with children and their families. Structured theoretical and practical training is recommended to strengthen professional skills.

Keywords: palliative care, pediatric oncohematology, nurses, knowledge, training needs.